

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Szejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Mr.sc Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit R.I., komuna e Vushtrisë, të cilin e përfaqëson Z.K.,av.nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.A. K.E.K., në Prishtinë, për kompensimin e përkohshëm të pagave, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.517/2007, datë 11.03.2008, në seancën e mbajtur më 26.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr.517/2007, datë 11.03.2008.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.517/2007, datë 11.03.2008, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komonale Prishtinë, C.nr.407/2006, datë 27.12.2007, me të cilin është miratuar kërkesëpadia e paditësit R.I., nga komuna e Vushtrisë dhe është detyruare paditura që paditësit, në emër të kompensimit të përkohshëm të pagës, parashikuar me marrëveshjen e lidhur mes paditësit dhe të paditurës, nr. 2979 të datës 21.8.2001, për periudhën prej 01.09.2006 deri më 31.12.2006, t'ia paguajë shumën prej 420 €, kurse nga data 01.01.2007 derisa të ekzistojnë kushtet e parashikuara në marrëveshje, t'ia paguajë nga prej 105 € në muaj deri në datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 179.40 €, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kanosjen e përmbarimit me detyrim.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës, me aktgjykimin Rev.nr.264/2008, datë 10.02.2009, e ka pranuar revizionin e saj dhe i ka

ndryshuar aktgjykimin e Gjykata e Qarkut Prishtinë, Ac.nr.517/2007, datë 11.03.2008, dhe aktgjykimin e Gjykatës Komonale Prishtinë, C.nr.407/2006, datë 27.12.2007, ashtu që e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të kompensimit të përkohshëm të pagës të parashikuar me marrëveshjen e lidhur mes ndërgjyqësve, nr. 2979, datë 21.08.2001, për periudhën prej 01.09.2006 deri me 31.12.2006, t'ia paguajë shumën prej 420 €, ndërsa prej datës 01.01.2007 derisa të ekzistojnë kushtet e parashikuara në marrëveshjen e përmendur, shumën mujore prej 105 €, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 179,40 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Paditësi, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.264/2008 datë 10.02.2009.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me aktgjykimin nr.K.I.53/2011, K.I. 25/2012, K.I. 100/2012 dhe K.I.49/2013, datë 14 tetor 2013, e ka shpallur si të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.264/2008, datë 10.02.2009, duke ia kthyer çështjen Gjykatës Supreme për rivendosje, me arsyetimin se ka gjetur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 31 të Kushtetutës, lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. Sipas marrëveshjes nr.2979, datë 21.8.2001, për kompensim të përkohshëm të pagës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërgjyqësit janë dakorduar që paditësi ta ndërpresë marrëdhënien e punës tek e paditura, e cila të marrë përsipër detyrimin t'ia paguajë atij kompensimin e pagës në shumën mujore prej 106 DM që, e konvertuar në euro, kap shumën prej 105 €. Me nenin 3

të marrëveshjes është parashikuar detyrimi i të paditurës që paditësit t'ia paguajë pagën prej datë 21.08.2001 deri në ditën e funksionimit të Fondit për Sigurim Pensional e Invalidor të Kosovës. E paditura, në bazë të nenit 14 të rregullores së UNMIK-ut "Për pensionet", nr. 2001/35, dt. 22.12.2001, ka themeluar Fondin suplementar pensional, nga i cili ka bërë pagesën e kompensimit për palët. Bordi ekzekutiv i të paditurës, me pikën 1 të vendimit nr.3873/11, datë 25.07.2006, e ka shfuqizuar vendimin dhe aktet e tjera në bazë të cilave është themeluar Fondi suplementar i pensioneve dhe ka ndërprerë financimin e tij, nga i cili edhe paditësit i bëhej pagimi i kompensimit - pensionit suplementar. Paditësi, duke qenë i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e kompensimit.

Në bazë të kësaj gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, prandaj e ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pabazuar.

Nisur nga gjendja e këtyre çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se gjykatat e instancave më të ulëta, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, e kanë zbatuar drejt të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se aktgjykimet e tyre nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës, datë 15.05.2009 (të përmendur në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese), Fondi i Sigurimit Invalidor dhe Pensional nuk është funksional. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/40 "Për shpallen e ligjit 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë", i cili rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Ligj, nuk e rregullon themelimin e sigurimeve pensionale dhe invalidore të vendit. Themelimi i Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Pensionet Invalidore, i cili është në proces të

hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës. Në po këtë njoftim theksohet se, në kohën e shkrimit të këtij shënimi, pensioni inter alia ekzistonte, pensioni invalidor në shumën prej 45 €, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (përfitues të tij janë të gjithë personat me aftësi të kufizuar - të përhershme dhe të plotë), si dhe personat e kontribut-dhënësve prej 82 €, të cilat rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë të gjithë personat që kanë arritur moshën e pensionit prej 65 vjetësh dhe të cilët kanë 15 vjet përvojë pune).

Nisur nga provat e lartpërmendura del se e paditura ka vazhduar t'ia paguajë shumën e cekur paditësit deri në datën 30.8.2006, me gjithë faktin se Rregullorja nr. 2003/40 ka qenë me efekt veprimi deri më 01.01.2004.

Duke marrë për bazë faktin se themelimi i Fondit të Sigurimeve Pensionale dhe Invalidore në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Pensionet Invalidore, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës, Gjykata Supreme vlerëson se ende qëndron detyrimi i të paditurës që ndaj paditësit të përmbushen obligimet sipas Marrëveshjes së nënshkruar mes palëve ndërgjyqëse dhe ky derisa të themelohet Fondi i lartpërmendur apo derisa paditësi ta arrijë moshën e pleqërisë – 65 vjeç.

Për këto fakte, Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet në revizion se gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale kur kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Nga sa u parashtrua dhe me zbatimin e dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.103/2016, më datë 26.4.2016

Kryetarja e kolegjit,
Gyltene Sylejmani

